



NATO



Meetings of NATO Ministers of Defense

8-11 2023

Réunion des ministres de la défense de l'OTAN



1-8 QERSHOR

JAVA E MBROJTJES

MINISTRI I MBROJTJES NË MINISTERIALIN E NATO-S

Ministri i Mbrojtjes, z. **Pirro Vengu**, mori pjesë në takimin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të **NATO-s**, i zhvilluar në **selinë** qendrore të Aleancës në Bruksel. Ky ministerial u zhvillua në prag të **Samitit** të NATO-s që do të mbahet në **Hagë** dhe kishte si qëllim përgatitjen përfundimtare të vendimeve **strategjike** që do të **adresohen** në nivelin më të lartë të Aleancës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

STËRVITJA “DEFENDER 25”

Forcat e Armatosura vazhdojnë pjesëmarrjen në stërvitjen ndërkombëtare “Defender 25”, një nga më të mëdhatë dhe komplekset e dekadës në Europë dhe Afrikë. Stërvitja zhvillohet në tokë, det dhe ajër, nën udhëheqjen e Komandës Europiane të SHBA dhe në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët e NATO-s.



mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

KRIJOHET KOMANDA E KIBERNETIKËS DHE NDËRLIDHJES

Komanda e Kibernetikës dhe Ndërlidhjes është tashmë njësia më e re **struktuore** brenda Forcave të Armatosura, e cila synon përforcimin e sigurisë kombëtare dhe **modernizimin** e **kapaciteteve** ushtarake në fushën kibernetike. Në ceremoninë e prezantimit, ministri Vengu e konsideroi këtë krijim një **hap kyç** për **avancimin** e sigurisë në epokën digjitale.





ZV.MINISTRJA ABRAZHDA NË SAMITIN “WOMEN, PEACE AND SECURITY”

Zëvendësm Ministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, mori pjesë në Samitin “Women, Peace and Security” në Prishtinë, të mbështetur nga OKB dhe nën kujdesin e Presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani. Ajo zhvilloi takime me përfaqësues të NATO-s dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, si dhe një takim bilateral me Presidenten Osmani për bashkëpunimin institucional dhe mbështetjen e Shqipërisë në integrimin euroatlantik të Kosovës. ★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

OPERACION DEMONSTRUES I EMERGJENCAVE CIVILE

Në Bazën e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile në Elbasan u zhvillua aktiviteti “**Mësim tregues**”, ku u testuan kapacitetet reale për përballimin e situatave emergjente. **Operacione kërkim-shpëtimi**, ndërhyrje pas tërmetesh, fikje zjarresh dhe akomodim fushor ishin pjesë e **demonstrimeve** praktike.



EFEKTIVËT E FA NË STËRVITJEN “LAUFER-25”

Efektivë të Kompanisë së Zbulimit të Regjimentit të Operacioneve Speciale po marrin pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “Laufer-25” në Slunj, Kroaci, pjesë e “Immediate Response 25”. Ata kryejnë detyra në fushën e HUMINT dhe vëzhgimit ajror me sistemin pa pilot “PUMA RQ-B20”.

